

VENDIM

Nr.88, datë 7.2.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.502, DATË 13.7.2011 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË  
KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr.10 119, datë  
23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të  
Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e nenit 47 të "Rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", miratuar  
me vendimin nr.502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë  
vijon:

"1. Vendimet e miratuara nga KRRTRSH-ja, para fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10  
119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, mbeten në fuqi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha